



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**

Nr. 246 / Prot.

Patos, më 05 / 02 /2024

**MIRATOHET  
KRYETARI  
Fation Duro**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 08, datë 05 / 02 /2024

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË QIRASË TË LIDHUR MIDIS  
AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE  
KONFISKUARA TIRANË DHE BASHKIVE TË QARKUT FIER.**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Mbështetur në nenet 3, 8, 9, 14, 23, 32, 33, 54 shkronja “gj”, 64 pika “c” të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane”, ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 03.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane” kërkesës nr. 3080 prot., datë 22.09.2023 të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe vendimit nr. 64, datë 30.10.2023 “Për dhënien e dakortësisë për marrjen në përdorim të landfillit të mbetjeve urbane të administruar nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë”, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

1. Miratimin e kontratës së qirasë të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier.
2. Pjesë e projektvendimit është kontrata e qirasë nr. 246 prot., datë 26.01.2024.

**EKIPI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE**

**Drejtues i Ekipeve të Menaxhimit**

Eneo Xhaferi

**Anëtar të Ekipeve të Menaxhimit**

Afërdita Muço

Boreta Murati

Valbona Semanjaku

Joana Zeqiraj

**Kordinator i GMS**

Shkëlqim Beqiraj

**Juriste**

Nurkë Hazizaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 246 / Prot.  
2

Patos, më 15/02/2024

RELACION

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË QIRASË TË LIDHUR MIDIS  
AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE  
KONFISKUARA TIRANË DHE BASHKIVE TË QARKUT FIER.**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Me vendimin nr. 64, datë 30.10.2023 u dha dakortësia për Bashkinë Patos, për marrjen në përdorim me qira 1 (një) euro, nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë, për marrjen me qira të pasurive si, rrugën hyrëse, peshoren dhe vend depozitimit të mbeqjeve urbane. Me dhënien e dakortësisë nga Këshilli u nënshkrua kontrata e qirasë 1 (një) euro me nr. 246 prot., datë 26.01.2024.

Kjo kontratë u nënshkrua me palë qiradhënëse Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe palë qiramarrëse Bashkitë e Qarkut Fier.

Afati i kontratës është 1 (një) vit duke filluar nga data 18.01.2024 - 17.01.2025, me të drejtë rinovimi dhe çmimi i qirasë do të jetë 1 (një) euro në muaj, i cili do të shlyhet në formën e parapagimit.

Një nga detyrat kryesore e palës qiradhënëse është dorëzimi i sendit në datën e fillimit të qirasë dhe në gjendjen fizike për të cilën palët janë dakortësuar paraprakisht me njëri-tjetrin.

Një nga detyrat kryesore e palës qiramarrëse është marrja në dorëzim e objektit brenda afatit të caktuar dhe ta përdorë atë sipas destinacionit të parashikuar në kontratë.

Pasi shqyrtoi përmbajtjen dhe kushtet e parashtruara në kontratën e qirasë me propozim të Kryetarit të Bashkisë i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë kontratën e qirasë të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier, nr. 246 prot., datë 26.01.2024.
2. Efektet financiare do të mbulohen nga fondet e trashëguara.
3. Për ndjekje dhe zbatimin e kësaj kontrate ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Publike Patos dhe drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social.

**EKIPI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE**

**Drejtues i Ekipit të Menaxhimit**

Eneo Xhaferi

**Anëtar të Ekipit të Menaxhimit**

Afërdita Muço

Boreta Murati

Valbona Semanjaku

Joana Zeqiraj

**Kordinator i GMS**  
**Shkëlqim Beqiraj**

**KRYETARI**  
**Fation Duro**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
SEKTORI I PROTOKOLL - ARKIVËS

KARTELA SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Bashkia e Qarkut Fier Nr. Prot. \_\_\_\_\_, Data \_\_\_\_\_

26/01/2024,

Shkurtimi i lëndës Mbi kontratën e qirorë për llogaridhën.

Për trajtim nga:	<u>Sec. Përgjithshme</u>
(Struktura të tjera të ngarkuara)	<u>Dr. Fushkes, Sec. Juridik</u>
Me porosi:	<u>Jë përgatitet Projekt vendimi për të kaluar në kontratën e qirorë</u>

Afati:  Normal (7 ditë)  Prioritet (3 ditë)  Urgjent (brenda ditës)  Fara/ për ditë  Tërheqje

Data 26/01/2024, Nr. Prot. 246, Nënshkrimi: Faton Duro

Marrë në dorëzim     /     /2024 Nënshkrimi: \_\_\_\_\_  
Kalon për trajtim (struktura): \_\_\_\_\_  
Me porosinë: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim     /     /2024 Nënshkrimi: \_\_\_\_\_  
Kalon për trajtim (struktura): \_\_\_\_\_  
Me porosinë: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim     /     /2024 Nënshkrimi: \_\_\_\_\_  
Kalon për trajtim (struktura): \_\_\_\_\_  
Me porosinë: \_\_\_\_\_

Trajtimi i materialit përfunduar më:     /     /2024, Specialisti \_\_\_\_\_  
Trajtimi i materialit pranuar më:     /     /2024, Eprori në shkallë hierarkike \_\_\_\_\_  
Trajtimi i materialit miratuar më:     /     /2024, Eprori në shkallë hierarkike \_\_\_\_\_  
Trajtimi i materialit miratuar më:     /     /2024, Eprori në shkallë hierarkike \_\_\_\_\_

Adresa : Lagja "Naftetari", Rruga "Unaza", Patos [www.bashkiapatos.gov.al](http://www.bashkiapatos.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E BRENDSHME

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA

Nr. 268 prot.

Tiranë, më 18.01 .2024



Nr. 739 Prot.

Nr. 783 Prot.

Nr. 531 Prot.

Nr. 475 Prot.

Nr. 246 Prot.

Nr. 416 Prot.

Dt. 24/01/2024

Dt. 26/01/2024

Dt. 26/01/2024

Dt. 26/01/2024

Dt. 26/01/2024

Dt. 26/01/2024

**KONTRATË QIRAJE**

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA, TIRANË, me numër identifikimi NIPT K82102451K, përfaqësuar nga Kryeadministratori i saj **Z. Adrian Koni**, lindur dhe banues në Tiranë, me shtetësi Shqiptare, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokument identifikimi, letërnjoftim me nr.personal G90109028D, referuar në këtë kontratë me cilësinë e **QIRADHËNËSIT**.

Dhe

**BASHKIA FIER**, me numër identifikimi NIPT K52905406F, përfaqësuar nga Kryetari **Z.Armando Subashi**, me shtetësi Shqiptare, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, referuar në këtë kontratë në cilësinë e **QIRAMARRËSIT**.

**BASHKIA LUSHNJË**, me numër identifikimi NIPT J64324443V, përfaqësuar nga Kryetari **Znj. Eriselda Sefa**, referuar në këtë kontratë në cilësinë e **QIRAMARRËSIT**.

**BASHKIA DIVJAKË**, me numër identifikimi NIPT L64613402K, përfaqësuar nga Kryetari **Z. Josif Gorrea**, referuar në këtë kontratë në cilësinë e **QIRAMARRËSIT**.

**BASHKIA PATOS**, me numër identifikimi NIPT J63208406B, përfaqësuar nga Kryetari **Z.Fatjon Duro**, referuar në këtë kontratë në cilësinë e **QIRAMARRËSIT**.

**BASHKIA ROSKOVEC**, me numër identifikimi NIPT L63327402A, përfaqësuar nga Kryetari **Znj.Majlinda Bufi**, referuar në këtë kontratë në cilësinë e **QIRAMARRËSIT**.

**BASHKIA MALLAKASTËR**, me numër identifikimi NIPT K17621104C, përfaqësuar nga Kryetari **Z.Qerim Ismailaj**, referuar në këtë kontratë në cilësinë e **QIRAMARRËSIT**.

Këtu e më poshtë të referuar si "**PALET**" sipas cilësimit të sipërpërmendur, Duke mbajtur në konsideratë se:

- Me Vendim Nr. 134 , datë 28/03/2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Shoqëria Integrated Technology Ëaste Treatment Fier" shpk, me seli qëndrore në Fier, është sekuestruar dhe është në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Tiranë

.Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë, me shkresën Nr.3080 prot , datë 22/09/2023, me objekt "Propozim për marrjen me qira të lanfilldit të përpunimit të mbetjeve urbane Fier", u ka propozuar Bashkive të Qarkut Fier, respektivisht: Bashkisë, Fier, Bashkisë Lushnjë, Bashkisë Divjakë, Bashkisë Patos, Bashkisë Roskovec, Bashkisë Mallakastër,

marrjen me qira 1 (një) euro, vetëm e pjesës së landfilit të mbetjeve urbane , peshimit dhe rrugës hyrëse të Impiantit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier.

-Këshillat Bashkiakë të Bashkisë, Fier, Bashkisë Lushnjë, Bashkisë Divjakë, Bashkisë Patos, Bashkisë Roskovec, Bashkisë Mallakastër, kanë vendosur për dhënien e dakordësisë për marrjen me qira 1 (euro) nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Tiranë për pjesën e landfilit të mbetjeve urbane , peshimit dhe rrugës hyrëse të Impiantit Urbane të Qarkut Fier, dhe kanë autorizuar Kryetarët e Bashkive të sipërpërmendura për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e kontratës së qirasë .

-Kuatridhjetor në fuqi parashikon për Njësitë e vetqeverisjes vendore (Bashkitë) e Qarkut FIER detyrime ligjore në lidhje me menaxhinin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane nëpërmjet kryerjes së funksioneve të veta në fushën e shërbimeve publike .

Për sa më sipër palët bien dakord që të lidhin midis tyre këtë kontratë qiraje , në kuptim të neneve 841-848 të Kodit Civil.

## NENI 1

### BAZA LIGJORE

Kjo Kontratë Qiraje do të mbështetet në dispozitat ligjore të:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr.139/2015 "Per Vetqeverisjen Vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr.10192, date 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar;
- Ligjin 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara", i ndryshuar;
- Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"; i ndryshuar; Ligjin nr.10463 datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i amenduar me Ligjin nr. 156, datë 10.10.2013; Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve 2010-2025 dhe Shtojcat për zbatimin e tij, miratuar me VKM Nr.418, datë 27.5.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035"; Plani kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta;
- Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar;
- Vendimi nr.134, datë 28.03.2022 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- Udhëzimi nr.324, dt.02.10.2020 i Ministrit të Brendshëm: "Për përcaktimin e rregullave, procedurave për administrimin e të ardhurave dhe limiteve të kryerjes së shpenzimeve për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara";
- Vendimi nr 111 datë 28.09.2023 të Këshillit Bashkiak Fier;
- Vendimi nr 86 datë 27/10/2023 të Këshillit Bashkiak Lushnjë;
- Vendimi nr 90 datë 31/10/2023 të Këshillit Bashkiak Roskovec;
- Vendimi nr 64 datë 30/10/2023 të Këshillit Bashkiak Patos;
- Vendimi nr 52 datë 27/10/2023 të Këshillit Bashkiak Divjakë;
- Vendimi nr 66 datë 21/12/2023 të Këshillit Bashkiak Mallakastër.

## NENI 2

### OBJEKTI I KONTRATËS

1. Qiradhënësi i jep me qira Qiramarrësit, pasuritë si më poshtë : Rruga hyrëse, Peshorja dhe Vend-depozitimi (Landfilldi) i mbetjeve urbane "qeliza" të shoqërisë " Integrated Technology Waste Treatment Fier " të pasqyruara në planvendosjen e përgatitur dhe mbi bazën e së cilës do të hartohet procesverbali i marrjes në dorëzim nga palët kontraktore;
2. Qiramarrësi pranon të marrë me qira e cituara në nenin 2 pika 1 të kësaj kontrate dhe të vazhdojë të ushtrojë këtë veprimtari në shërbim të menaxhimit të mbetjeve urbane duke u përkujdesur për administrimin e veprimtarisë ekonomike, në përputhje me destinacionin ekonomik të sendit.
3. Pas verifikimit të detajuar në terren të pasurisë, palët bien dakord që referuar gjendjes teknike të peshores ajo është në gjendje funksionale. Gjendja e detajuar e pasurive objekt i kësaj kontrate do të përshkruhen në procesverbalin e dorëzimit të sendit, i cili do të jetë pjesë integrale e kësaj kontrate.

## NENI 3

### DESTINACIONI I PËRDORIMIT TË OBJEKTIT

1. Destinacioni i përdorimit të objektit të kontratës së qirasë është:  
*Menaxhimi vetëm i rrugës hyrëse, peshores dhe vend-depozitimit (Landfilldi) të mbetjeve urbane, në Impiantin e Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier.*
2. Qiramarrësi nuk mund të ndryshojë destinacionin e përdorimit të objektit.

## NENI 4



### AFATI I KONTRATËS

1. Kjo kontratë qiraje lidhet me afat një vjeçar, afti i së cilës fillon nga data **18.01.2024-17.01.2025** palët me të drejtë rinovimi.
2. Pas përfundimit të këtij afati, kontrata mund të rinovohet me shkrim nga Palët.
3. Në datën e mbarimit të kësaj kontrate, nëse palët nuk bien dakord për rinovimin e saj, objekti do t'i dorëzohet Qiradhënësit.

## NENI 5

### ÇMIMI I QIRASË DHE MËNYRA E PAGESËS

1. Palët bien dakord që çmimi i qirasë të jetë një (1) Euro/ Muaj/ Neto dhe për efekt të detyrimeve financiare sipas legjislacionit në fuqi, pagesa të kryhet nga Bashkia Fier .
2. Në rast të rinovimit të kontratës, çmimi i qirasë dhe mënyra e pagesës do të negociohen midis palëve.
3. Pagesa e detyrimit mujor të qirasë, të përcaktuar në nenin 5 pika 1 të kësaj kontrate, do të shlyhet në formën e parapagimit.
4. Pagesa do të kryhet brenda datës 5 të çdo muaji, për muajin vijues. Për muajin e parë të kontratës pagesa bëhet pas përfundimit të nënshkrimit të kontratës nga të gjitha palët, dhe hyrjes në fuqi të saj, dhe shuma për t'u paguar, llogaritet në proporcion me ditët e këtij muaji.
5. Pagesa për Qiradhënësin bëhet:
  - Pranë llogarisë "Të ardhura dhe shpenzime për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara në administrim të A.A.P.S.K",
  - Në Nr. Llogarisë AL2320811008000002022330702 lekë në Bankën Intesa Sanpaolo



dhe vërtetohet me dokumentin bankar përkatës.

6. Pagesa për tatimin në burim bëhet në llogaritë e autorizuar nga organet tatimore për këtë qëllim. Qiramarrësi do t'i vërtetojë Qiradhënësit pagesën e tatimit në burim me anë të dokumentit bankar përkatës.

#### NENI 6

#### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

1. Qiradhënësi duhet t'i dorëzojë sendin në datën e fillimit të qirasë dhe në gjendjen fizike për të cilën palët janë dakordësuar paraprakisht me njëri-tjetrin.
2. Qiradhënësi ka detyrimin të garantojë Qiramarrësin gjatë gjithë periudhës për të cilën do të zgjasë kontrata e qirasë, për shqetësimet që mund të lindin nga të tretë, të cilët mund të pretendojnë se kanë të drejta mbi objektin e kontratës.
3. Qiradhënësi është i detyruar të njoftojë menjëherë Qiramarrësin, për çdo ndryshim eventual të kushteve të kësaj kontrate, duke vepruar gjithmonë me korrektësi dhe mirëbesim.
4. Qiradhënësi nuk mban përgjegjësi në qoftë se Qiramarrësi kryen një aktivitet, i cili është i kundraligjshëm. Në rast se nga ky aktivitet i kundraligjshëm bllokohet, apo dëmtohet ambienti, Qiramarrësi është i detyruar t'i paguajë Qiradhënësit dëmin e shkaktuar.
5. Qiradhënësi ka të drejtë të verifikojë në mënyrë periodike ushtrimin e veprimtarisë në objektin e kontratës së qirasë nga ana e Qiramarrësit. Këtë të drejtë ai duhet ta ushtrojë pasi të bëjë njoftim paraprak tek Qiramarrësi. Në çdo rast, kjo e drejtë nuk mund të çenojë veprimtarinë e përditshme dhe ecurinë normale të punës së Qiramarrësit.

#### NENI 7



#### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT

1. Të marrë në dorëzim objektin brenda afatit të caktuar dhe ta përdorë atë sipas destinacionit të parashkruar në këtë kontratë.
2. Qiramarrësi ka detyrimin ta përdorë objektin e marrë me qira pa bërë ndryshime apo shtesa në objekt.
3. Të përmbushë detyrimet kontraktore në shumën dhe afatin e caktuar në kontratë.
4. Qiramarrësi duhet të kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e objektit dhe përgjigjet për çdo dëmtim që i sjell objektit.
5. Qiramarrësi duhet t'i dorëzojë Qiradhënësit objektin në gjendjen në të cilën e ka marrë dhe në afatin e caktuar në kontratë.
6. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë objektin me nënqira, përdorim tek palë të tjera.
7. Qiramarrësi është i detyruar të zhvendosë Qiradhënësin për dëmet që i ka shkaktuar objektit gjatë kohëzgjatjes së kontratës së qirasë.
8. Qiramarrësi është i detyruar që të paguajë shpenzimet për energji elektrike, ujë, administrim të ambienteve, për çdo muaj si dhe çdo detyrim tjetër që lind nga përdorimi i objektit, që nga momenti i lidhjes së kontratës dhe gjatë gjithë kohës së ekzistencës së saj.

#### NENI 8

#### ZGJIDHJA E KONTRATËS

1. Kontrata do të konsiderohet e zgjidhur me plotësimin e afatit të saj, në qoftë se nuk është rinovuar.
2. Në qoftë se pasuria i kthehet pronarit, atëherë kjo kontratë zgjidhet dhe marrëdhënia kontraktore përfundon para afatit. Në një rast të tillë, A.A.P.S.K nuk do të ngrejë asnjë pretendim kundrejt Qiramarrësit dhe as Bashkitë, Palë të kësaj kontrate, kundrejt A.A.P.S.K-së.
3. Qiradhënësi ka të drejtë të zgjidhë menjëherë këtë kontratë qiraje në këto raste:





- Qiramarrësi nuk paguan qiranë në shumën dhe atatin e caktuar sipas pikës 3 të kësaj kontrate, për të paktën 3 (tre) muaj.
  - Qiramarrësi ndryshon destinacionin e përdorimit të objektit.
  - Konstaton se Qiramarrësi ka dëmtuar rëndë objektin e marrë me qira.
  - Në rast se objekti i kontratës së qirasë nuk është më në administrim të A.A.P.S.K.
4. Në çdo rast Qiradhënësi ka detyrimin ligjor të njoftojë me shkrim Qiramarrësin për zgjidhjen e kontratës, të paktën 15 ditë përpara.
  5. Qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje në çdo kohë, duke njoftuar zyrtarisht me shkrim Qiradhënësin A.A.P.S.K. të paktën 1 (një) muaj përpara.
  6. Qiramarrësi ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë qiraje duke njoftuar me shkrim 1 (një) muaj përpara, kur Qiradhënësi nuk garanton për shqetësimet që mund të lindin nga të tretë, të cilët pretendojnë se kanë të drejta mbi këtë objekt. Në këtë rast Qiramarrësi nuk mban përgjegjësi kundrejt Qiradhënësit.
  7. Përveç palëve kontraktuese, askush nuk ka asnjë të drejtë të zgjidhë këtë kontratë para mbarimit të afatit të caktuar apo të kërkojë ndryshimin e kushteve të vëna në këtë kontratë, përveç se me marrëveshje me shkrim midis palëve.
  8. Në raste të ngjarjeve që përbëjnë forcë madhore, të tilla si tërmet, luftë, përmytje, epidemi, greva të përgjithshme, palët mund të dakordësojnë zgjidhjen e kësaj kontrate. Në këtë rast kjo kontratë quhet e prishur dhe asnjë nga palët nuk mban përgjegjësi.

#### NENI 9

#### MËNYRAT E KOMUNIKIMIT


1. Mënyra e komunikimit mes palëve kontraktuese do të jetë me shkrim në adresat e mëposhtme
  - Qiradhënësi : Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara Rruga "Kavajës" Kompleksi "Delijorgji", Kulla C1, K.1, H.2, Tiranë.
  - Qiramarrësi: Bashkia Fier, Lushnje, Patos, Roskovec, Divjakë, Mallakastër Adresa: Selitë e Bashkive respektive.
2. Për çdo ndryshim të këtyre adresave, palët do të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën me shkrim.
3. Kjo Kontratë nuk mund t'i transferohet apo kalohet ndonjë pale tjetër.

#### NENI 10

#### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar. Për çdo çështje që nuk rregullohet nga kjo Kontratë do të zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
2. Në rast mosmarrëveshje midis Palëve lidhur me interpretimin, ekzekutimin, shkeljen, përfundimin apo zbatueshmërinë e kësaj Kontrate dhe Shtojcave përkatëse, Palët do të takohen dhe përpiqen në mirëbesim të zgjidhin, sa më shpejtë që të jetë e mundur, mosmarrëveshjen në fjalë.
3. Nëse kjo mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet bisedimeve direkte, mosmarrëveshja do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë u hartua në 10 ( dhjetë ) kopje me vlerë të njëjtë dhe pasi u lexua nga palët, nënshkruhet me vullnetin e plotë, të lirë prej tyre dhe vuloset me vulën e institucionit, ku secila palë merr nga një kopje.



PALËT NËNSHKRUESE

PALA QIRADHËNËSE

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA, TIRANË përfaqësuar nga Kryeadministratori i saj **Z. Adrian Koni**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)

*Adrian Koni*

PALA QIRAMARRËSE

1. **BASHKIA FIER**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë **Z. Armando Subashi**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)

2. **BASHKIA LUSHNJE**, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë **Znj. Eriselda Sefa**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)

3. **BASHKIA PATOS**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë **Z. Fatjon Buro**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)

4. **BASHKIA ROSKOVEC**, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë **Znj. Majlinda Bufi**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)

5. **BASHKIA DIVJAKË**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë **Z. Josif Gorrea**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)

6. **BASHKIA MALLAKASTËR**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë **Z. Qerim Ismaili**

Nënshkruar (Emër Mbiemër, firmë, vulë)

## PROCES-VERBAL

I mbajtur sot me dt. 29/01/2024 midis paleve perfaqesese te Bashkive te Qarkut Fier dhe Perfaqesuesve te Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Mbeshtetur ne Kontraten e Qirase Nr.268 Prot. Dt. 18/01/2024 te lidhur midis Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe konfiskuara dhe Bashkive te Qarkut Fier.

Palet pefaqesuese te Bashkive te Qarkut Fier jane:

1. BASHKIA FIER PERFAQSUAR NGA, Z. Fatjon Elezaj
2. BASHKIA LUSHNJE PERFAQSUAR NGA, Z. Jorgen Prifti
3. BASHKIA PATOS PERFAQSUAR NGA Z.Enea Xhaferi
4. BASHKIA ROSKOVEC PERFAQSUAR NGA, Z. Eduart Ruko
5. BASHKIA DIVJAKE PERFAQSUAR NGA, Z. Cerçiz Turhani
6. BASHKIA MALLAKASTËR PERFAQSUAR NGA, Z. \_\_\_\_\_

Palet pefaqesuese te Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara jane:

Z. Arjan Baci

Z. Sotir Sema

Z. Musa Hyka

U mor ne dorezim Landfilli dhe materialet si me poshte sipas kontrates se Qirase:

-Porta Hyrese e Landfillit me 2 (dy) shina, (1cope).

-Ne te majte te hyrjes se Landfillit 3(tre) konteniere.


-Ambienti lidhet me portat te cilat lidhen me gjithe Landfillin.

-Ne te djathte te hyrjes ndodhet 1(nje) Gabine.

-Rruga hyrese vazhdon me 2(dy) peshore, 1(nje) ne te majte dhe 1(nje) ne te djathte ( funksionale) te Landfillit.

-Ne te djathte ndodhet 1(nje) kontenier me paisjet si me poshte:

- 1- 2(dy) Kompjutera te kompletuar
- 2- 1(nje) Printer per flete-peshat
- 3- 1(nje) tavoline
- 4- 2(dy) karrige
- 5- 1(nje) mini dollap
- 6- Sistemi elektrik
- 7- 1(nje) korrese bari
- 8- 1(nje) kondicioner
- 9- Llampa ndricimi.



-Ne te djathte te portes jane 2(dy) shtylla ndricimi me nga 1(nje) koke, ne te djathte jane 6(gjashte) shtylla me 2(dy) koka, 2(dy) kaseta, zjarrfikse , 2(dy) kamera.

-Ne te majte 1(nje) depozite uji 3ton.

-Te rruga hyrese deri ne perfundim te peshores rruga eshte 3-kalimshe, pjesa tjeter eshte 2-kalimshe der ne hyrje.

-Ne hyrje te Landfillit jane 2(dy) gropa uji, ne te djathte 5-shtylla ndricimi me nje koke dhe ne te majte 9(nente) shtylla der ne fund te Landfillit.

-Gropat e hirit jane te 2(dy) te ndotura dhe me mbetje urbane, 2(dy) shtylla elektrike, ne to ndodhen 2(dy) pompa thithese te ndotura per pastrimin e ujit.

-Rruga mes Landfillit dhe gropave te hirit jane te ngarkuara me mbetje ne te cilat ndodhen 2(dy) shtylla ndricimi, ne te djathte 7 (shtate)shtylla ndricimi dhe 2(dy) pompa te mbuluara nga plerat jashte fuxionit.

-Tubi anesore qe lidh pompat me vasken e ujit eshte i demtuar pjeserisht dhe 3(tre) pompat e ujit jashte funksionit.

-Reth e qark Landfillit ndodhen 10(dhjete) kaseta kunder zjarrit me 4(kater) shtylla ndricimi me nga nje koke.

-Mbrapa Landfillit ne mes te gropes ndodhet nje mjet shtytes jashte funksionit per te cilin nuk mund te behet nje vleresim.

-Sistemi I ndricimit punon vetem ne pjesen hyrese te Landfillit ne pjesen e pasme energjia eshte e shkeputur. Ne ambientin e Landfillit ndodhet dhe nje mjet Citroen me targa AA 961 HC

(4+1 vende) me motorino te prishur.

#### Grupi I marrjes ne dorzim

1. Z. Fatjon Elezaj Kryetar
2. Z. Jorgen Prifti Anetar
3. Z.Enea Xhaferi Anetar
4. Z. Eduart Ruko Anetar
5. Z. Cerciz Turhani Anetar
6. Z. \_\_\_\_\_

#### Grupi i dorzimit

- |               |        |
|---------------|--------|
| Z. Arjan Baci | Krytar |
| Z. Sotir Sema | Anetar |
| Z. Musa Hyka  | Anetar |

Arjan Baci  
S. Sema  
dt. 23.01.2024